Kronikë

(EMRAT) Burrel, arrestohet 23-vjeçari dhe shpallet në kërkim vëllai i tij, shisnin drogë afër shkollave! U sekuestrohet çanta plot me doza kanabis dhe arsenal armësh

Një shtetas i identifikuar si Jurxhini Sada është arrestuar nga policia e Burrelit pasi akuzohet se shiste doza kanabisi në afërsi të shkollave dhe jo vetëm, në bashkëpunim me vëllain e tij të quajtur Andi Sada, i cili është shpallur në kërkim.

Redaksia
2 Dhjetor, 10:14 | **Përditësimi: 2 Dhjetor, 10:37**

Share

Burrel - Një 23-vjeçar është arrestuar nga policia e Burrelit, si dhe është shpallur në kërkim vëllai i tij 22-vjeçar, pasi akuzohen se shisnin doza kanabsi, në afërsi të shkollave dhe në zona të ndryshme të qytetit të Burrelit.

23-vjeçari i identifikuar si Jurxhini Sada, pasi ka parë uniformat blu ka hedhur nga dritarja e automjetit tip "Benz", të cilin po drejtonte, një sasi kanabisi dhe një dorezë hekuri, dhe ka tentuar të largohej por pa sukses.

LEXO EDHE:
Përplasi të miturin në Burrel, arrestohet shoferi i automjetit në pronësi të kompanisë 'Breçani Security'

Gjatë kontrolleve në banesën e dy vëllezërve policia ka gjetur një tjetër sasi lënde narkotike kanabis sativa, e ndarë në doza të gatshme për shitje (gjithsesj 174 doza), 47 fara cannabisi, 1 radio marrëse-dhënëse, 1 rrip multifunksional, 1 jelek si të Policisë, si dhe 2 shkopinj metalik, 1 mjet prerës (thikë) dhe 1 krehër kallashnikovi me 25 fishekë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provë materiale së bashku me dozat dhe me përforcuesin e grushtit, që u gjetën në momentin e ndalimit, celularin e të arrestuarit dhe automjetin tip "Benz", që përdorej për shpërndarjen e dozave të cannabisit.

Policia deklaron se nga hetimet e thelluara ka rezultuar 23-vjeçari kryente veprimtarinë kriminale në bashkëpunim me vëllain e tij, Andi Sada, 22 vjeç, i cili është shpallur në kërkim.

> *"Nga hetimet e thelluara ka rezultuar se shtetasi J. S. e kryente veprimtarinë kriminale të shitjes së dozave të lëndës narkotike cannabis sativa, së bashku më vëllanë e tij, shtetasin A. S., 22 vjeç. Vijon puna puna intensive për lokalizimin, kapjen dhe nxjerrjen e 22-vjeçarit, përpara përgjegjësisë penale",-njofton policia.*

Goditja e veprimtarisë kriminale të dy vëllezërve u bë në kuadër të megaoperacionit "Tempulli".

K.M/Shqiptarja.com

TAG: Diber

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Komision hetimor vetëm për çështje konkrete,jeni dakord me propozimin e PS?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Mjeti i 'Breçani Security' përplas të miturin, në pranga shoferi në Burrel
1 Dhjetor, 14:54

Pas djathit te bjeshkëve, Veleçikut edhe kumbulla e thatë e Dibrës me glikonë e arrës së Përmetit drejt çertifikimit identitar
30 Nëntor, 18:50

INSTAT: Tkurren me 7.4% lindjet në tremujorin e tretë të 2023! Më pak lindshmëri në Kukës e Dibër
Enxhi Musaj
30 Nëntor, 12:37

VIDEO/ Shikoni si është çarë toka në Dibër, dherat e balta mbuluan aksin nacional Klos - Qaf Buall! Banorët apel për ndihmë
Mahir Jangulli
30 Nëntor, 10:32

Aksident në Bulqizë, makina përplaset me autobusin, plagoset 61-vjeçari
30 Nëntor, 10:11

Reshjet shiu gjatë natës, rënie gurësh e inertesh në disa akse, ARRSH: Qarkullimi vijon pa problleme! Në Bulqizë prezencë uji në rrugë
29 Nëntor, 10:48

Reshjet/ Shembje masive gurësh në aksin Fushë Arrëz–Mirditë dhe në rugën e Arbrit! Era thyen pemët në Librazhd, dëme në disa biznese
28 Nëntor, 12:45

Në Dibër disa fshatra pa energji elektrike, 3 grupe të OSHE së Kavajës dhe Durrësit u shkojnë në ndihmë! Rrugët e kalueshme me zinxhir
27 Nëntor, 09:43

Reshje dëbore e ngrica! Bllokohet një orë në mbrëmje bypassi në rrugën e Arbrit! Lëvizja e mjeteve me zinxhirë! Fshatra pa energji në disa qarqe
26 Nëntor, 08:48

U bllokuan në Qafë Murriz, VIDEO nga momenti kur evakuohen 50 pasagjerë
25 Nëntor, 21:43

Kishin mbetur të bllokuar në Qafë Murriz, VIDEO nga momenti i shpëtimit të prindërve me dy fëmijë! Largohen me makinën e policisë
25 Nëntor, 19:27

300 mjete të bllokuar në Qafë Murriz, Policia: Do i evakuojnë drejt Klosit
25 Nëntor, 19:24

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButto

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje